

MINISTRI

URDHËR

Nr. 166 datë 27.4 2015

PËR

**MIRATIMIN E STATUTIT TË TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën" i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Statutit të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohet Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij Urdhëri dhe Drejtoria e Krijmtarisë së Fjalës dhe Përkthimit për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

  
MIRELA KUMBARO FURXHI




Adresa: Rruga Aleksandër Moisiu, nr 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re" Tiranë

Email: [info@kultura.gov.al](mailto:info@kultura.gov.al)

[www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al)

KOLCETI:

 P. Xhelo



**MIRATOHET**  
**MINISTRI I KULTURËS**  
**Mirela KUMBARO (FURXHI)**



**STATUTI**  
**I TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE**  
**ANSAMBLIT POPULLOR**

R. Xhepo



## **KREU I** **DISPOZITA TË PËRGJITSHME**

### **Neni 1** **Objekti**

Ky Statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (në vijim T.K.O.B.A.P).

### **Neni 2** **Statusi juridik**

1. T.K.O.B.A.P është institucion kombëtar me statusin e personit juridik, publik, në varësi të Ministrisë së Kulturës. T.K.O.B.A.P është institucion publik qendror i artit dhe i kulturës, i pavarur nga subjektet politike dhe grupet e tjera të interesit.
2. Aktiviteti i T.K.O.B.A.P ushtrohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dispozitat e ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar, legjislacionin shqiptar, statutin dhe rregulloren e brendëshme të funksionimit të saj.

### **Neni 3** **Selia, vula dhe stema**

1. T.K.O.B.A.P e ka selinë në Tiranë, Sheshi Skënderbej, në godinën ku ushtron aktivitetin. Ai ka vulën e tij në formë rrethore ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit, “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansmablit Popullor, Tiranë”.
2. T.K.O.B.A.P ka edhe stemën e tij sipas formatit bashkëlidhur.

## **KREU II** **PARIMET DHE DETYRAT**

### **Neni 4** **Parimet**

T.K.O.B.A.P në veprimtarinë e tij mbështet dhe përkrah lirinë e informacionit dhe të informimit si një e drejtë themelore e qytetarëve. Siguron qasje të barabartë për të gjithë.

*R. XHAYJA*



**Neni 5**  
**Detyra dhe funksionimi i T.K.O.B.A.P**

1. T.K.O.B.A.P zbaton politikat shtetërore dhe kombëtare në fushën e artit dhe kulturës.
2. T.K.O.B.A.P ka si mision ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave më të mira të teatrit muzikor dhe koreografik, shqiptar dhe botëror, përpunimin krijues të folklorit, nxitjen dhe interpretimin e krijimitarisë bashkëkohore shqiptare, ngritjen teknike dhe profesionale të interpretimit, larminë e individualiteteve interpretuese dhe krijuese, edukimin e publikut me veprat më të mira të teatrit muzikor koreografik dhe folklorit të përpunuar.
3. T.K.O.B.A.P ka si objekt të veprimtarisë së tij zhvillimin e artit dhe kulturës, ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, realizimin e veprave skenike të autorëve shqiptar dhe të huaj, eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike si dhe në ruajtjen, zhvillimin, kultivimin e vlerave etnomuzikore e koreografike si dhe promovimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
4. T.K.O.B.A.P ka për detyrë përsosjen e mjeteve shprehëse të interpretimit dhe ekzekutimit muzikor e koreografik, bashkëpunimin dhe inkurajimin e inisiativave frytdhënëse që ndihmojnë në realizimin e synimeve të tij. Për këtë, krahas ruajtjes së praktikave më të suksesshme të përvojës historike të deritanishme duhet të kërkojë edhe rrugë të reja si dhe të konvergojë me institucione analoge dhe operatorë të tjerë të fushës brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 6**  
**Bashkëpunimi ndërinstitucional**

1. T.K.O.B.A.P gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij hyn në marrëdhënie me persona juridikë vendas dhe të huaj, organizma qeveritare dhe joqeveritare si dhe individë të veçantë që veprojnë ligjërisht në fushën e artit dhe kulturës për të realizuar misionin dhe objektivat e tij.
2. T.K.O.B.A.P, për ruajtjen dhe zhvillimin e jetës artistike ka të drejtën e shkëmbimit të veprimtarive dhe trupave e individëve brenda dhe jashtë vendit si dhe në diasporën shqiptare duke u lidhur me ta në marrëdhënie kontraktuale me miratimin e Ministrisë Kulturës.

**KREU III**  
**AKTIVITETI ARTISTIK I T.K.O.B.A.P**

**Neni 7**  
**Kalendari artistik**

1. Për të zhvilluar veprimtarinë artistike vjetore, T.K.O.B.A.P, harton Kalendarin Artistik sezonal 4-mujor ose vjetor me vepra të repertorit dhe premiera, duke patur të drejtën e interpretimit dhe ekzekutimit të të gjitha zhanreve të muzikës së kultivuar.

R. XHAJA

1. Kalendarit Artistik miratohet nga Bordi Artistik i T.K.O.B.A.P në përputhje me politikat kulturore shtetërore.

2. Kalendarit shpallet për gjithë vitin kalendarik apo edhe sezonal. Me mbështetje të Bordit të Miqëve apo Sponsorave të ndryshëm, T.K.O.B.A.P mund të realizojë edhe vepra të përfshira paraprakisht në Kalendarin Artistik në marrëveshje mes palëve.

#### **Neni 8** **Aktivitete ndërkombëtare**

1. T.K.O.B.A.P merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare apo koncerte të ndryshme, festivale, turne etj, duke bashkëpunuar me institucione të tjera kulturore dhe artistike të interesuar për kulturën tonë.

2. Pjesëmarrja në këto aktivitete, kur ato janë të parashikuara në kalendarin e miratuar, bëhet me miratimin e bordit artistik dhe me mbështetjen financiare të palëve ftuese dhe sipas rastit edhe me miratimin apo mbështetjen e posacme nga Ministria e Kulturës, sponsorizimeve apo bashkëpunimeve të ndryshme.

#### **Neni 9** **Edukimi përmes artit**

1. T.K.O.B.A.P duke patur parasysh impaktin që ka në publik dhe në shoqërinë shqiptare në përgjithësi, harton dhe realizon projekte të edukimit të brezave dhe grupmoshave të ndryshme nëpërmjet artit të operas, baletit dhe artit popullor të përpunuar.

2. Politikat e edukimit përmes artit realizohen në bashkëpunim dhe me mbështetjen e institucioneve të tjera artistike dhe kulturore të arsimit dhe shkencës dhe bashkëpunorëve të tjerë të T.K.O.B.A.P, përmes projekteve të vetë institucionit apo edhe në bashkëpunim me institucione publike të qeverisjes vendore, shoqata joqeveritare, biznese private etj. Një vëmendje të veçantë në këtë drejtim i duhet kushtuar bashkëpunimit me mediat vizive dhe të shkruara, publike dhe jopublike.

#### **Neni 10** **Promovimi i artistëve të rinj**

1. T.K.O.B.A.P stimulon krijimin e hapsirave të veçanta për promovimin e artistave të rinj dhe bashkëpunimin me të gjithë ata të rinj që realizojnë kërkesat artistike në nivelin e kërkuar.

2. Pranimi i tyre si në rastet e kontratimit në marrdhënie punësimi si në vepra të veçanta apo përfshirja në projektet e institucionit bëhet mbi rezultatin e arritur në audicionet që organizohen, nga konkurimet për lidhjen e kontratave sipas nevojave të institucionit. T.K.O.B.A.P u krijon atyre kushte për aftësimin artistik e profesional dhe për të përmbushur kërkesat artistike.



3. T.K.O.B.A.P bashkëpunon me institucione arsimore të nivelit parauniversitar, universitar, qëndrat e perfeksionimit pas universitar brenda dhe jashtë vendit që i gjen me interes për të dërguar artistët për perfeksionimin sipas kërkesave të tij.

4. T.K.O.B.A.P organizon përzgjedhjen e artistëve që janë kontraktuar në të apo edhe të rinj të tjerë që nuk janë ende të angazhuar por që i konsideron të vlefshëm në përputhje me intereset e veta. Vendimet për përzgjedhjen e tyre nga juritë apo komisionet e ngritura për këtë qëllim, janë të përvokueshme pas miratimit nga titullari.

5. T.K.O.B.A.P ka të drejtë të përfshijë në stinët artistike vjetore mbrëmje koncertore dhe vepra të vecanta të realizuara nga artistë të rinj, të angazhuar nga institucioni apo edhe nga shkollat artistike me qëllim aftësimin dhe promovimin e tyre. Edhe në këtë rast, përzgjedhja bëhet nëpërmjet audicioneve ose duke u bazuar në rekomandimin e drejtorive të shkollave artistike.

6. Me qëllim nxitjen e praktikës skenike të të gjithë brezave që aspirojnë profesionin e artistit, T.K.O.B.A.P ka të drejtë të vendosi në dispozicion të artistëve të rinj, ambjentet e tij të shfaqjeve. Në rastet kur gjykohet e nevojshme shfaqjet e të rinjve mund të përfshihen edhe në kalendarin e tij apo në një rubrikë të vecantë kushtuar promovimit të talenteve të reja.

#### **Neni 11**

#### **Pronësia mbi prodhimtarinë**

1. Prodhimi skenik i T.K.O.B.A.P është pronë e tij.

2. T.K.O.B.A.P ushtron të drejtat e autorit dhe të drejtat mbi prodhimtarinë e tij dhe i respekton ato, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Marrëdhëniet juridike të bashkëprodhimeve dhe bashkëproduksioneve rregullohen me kontrata të cilat nënshkruhen dhe ekzekutohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. T.K.O.B.A.P, për ruajtjen dhe zhvillimin e jetës artistike ka të drejtën e shkëmbimit të veprimtarive dhe trupave e individëve brenda dhe jashtë vendit si dhe në diasporën shqiptare duke u lidhur me ta në marrëdhënie kontraktuale me miratimin e Ministrisë Kultures.

#### **KREU IV**

#### **ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI FINANCIAR**

#### **Neni 12**

#### **Struktura dhe organika**

Struktura dhe Organika e T.K.O.B.A.P miratohet me urdhër të Kryeministrit pas propozimit të Ministrit të Kultures.

R. XHAJA



**Neni 13**  
**Organet drejtuese**

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë organizative dhe artistike të T.K.O.B.A.P realizohet nga titullari i Institucionit dhe Bordi Artistik.

**Neni 14**  
**Drejtori i Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm i T.K.O.B.A.P-së emërohet nga Këshilli i Ministrave ndërmjet dy kandidaturave të propozuara nga Ministri i Kulturës. Shkarkimi i tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave bazuar në legjislacionin në fuqi.

**Neni 15**  
**Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm**

**1. Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca si më poshtë:**

- a) Drejton veprimtarinë e T.K.O.B.A.P-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e institucionit dhe Rregulloren e Brendshme të funksionimit të tij;
- b) Përfaqëson T.K.O.B.A.P në marrëdhënie me të tretët. Në mungesë të tij autorizon me shkrim njërin nga Drejtorët;
- c) Emëron dhe liron në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës të gjithë vartësit e tij;
- d) Nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e T.K.O.B.A.P-së;
- e) Përcakton strukturën e organizimit sipas sektorëve.

**Neni 16**  
**Bordi Artistik**

- 1. Bordi Artistik është organizëm kolegjal pranë institucionit të T.K.O.B.A.P i cili miratohet nga Ministri i Kulturës.
- 2. Antarët e tij mund të propozohen edhe nga titullari i institucionit. Titullari i institucionit thërret për mbledhje Bordin Artistik. Bordi Artistik funksionon në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjinale".
- 3. Anëtarët e Bordit Artistik janë personalitete të shquara të fushës së artit, kulturës dhe shkencës si dhe të veprimtarive shoqërore që kanë lidhje me të. Antarët nuk mund të jenë të punësuar në institucionin pranë të cilit funksionon ky bord.

R. XHAJA

4. Mandati i tyre është katër vjeçar me të drejtë ripërsëritje. Anëtari i Bordit Artistik, përpara marrjes së çdo vendimi është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se nuk ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi. Bordi Artistik si rregull mbledhet jo më pak se dy herë gjatë një sezoni artistik. Masa e shpërblimit të antarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 17**

#### **Kompetencat e Bordit Artistik**

1. Bordin Artistik i Institucionit Qëndror të Artit dhe Kulturës ka këto detyra:
  - a) Miraton në mbledhjen e parë rregullimin e funksionimit të tij, e cila propozohet nga titullari i institucionit;
  - b) Vendos repertorin artistik vjetor sipas kalendarit artistik të institucionit, në përputhje me politikën e Ministrisë së Kulturës;
  - c) Miraton projektet artistike, në përputhje me repertorin e vendosur;
  - d) Miraton kriteret dhe kushtet e shpërblimit të vlerës artistike për personelin nga jashtë vëndit si dhe për ata jashtë institucionit;
  - e) Miraton paraqitjen ose pjesëmarrjen e institucionit në festival dhe manifestime të tjera të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përcaktuar edhe projektin e pjesëmarrjes.

#### **Neni 18**


#### **Drejtorët e Drejtorisë së Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor**

1. Drejtorët e Drejtorive të T.K.O.B.A.P-së, emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm. Mandati i tyre është katër vjeçar.
2. Drejtorët e Drejtorive duhet të plotësojnë kriterin e diplomimit artistik dhe të jetë me kohë të plotë punësimi.
3. Drejtorët e Drejtorive marrin detyrat nga Drejtori i Përgjithshëm i institucionit dhe realizojnë objektivat, qëllimet dhe kalendarin artistik mbi të cilat ka vendosur bordi artistik.

#### **Neni 19**

#### **Të drejtat dhe detyrat e drejtorëve të drejtorive të T.K.O.B.A.P**

1. Drejtorët e Drejtorive kanë këto të drejta dhe detyra kryesore:
  - a) Të marrin pjesë në mbledhjet e bordit artistik pa të drejtë vote;
  - b) Të përcaktojnë dhe të shpallin planin e punës së sektorëve artistikë, duke u bazuar në kalendarin e sezonit artistik të shpallur;
  - c) Të propozojnë masa disiplinore në realizimin e këtij plani;
  - d) Të propozojnë kriteret, mënyrën e organizimit, të testim-audicioneve për:

R. XHAJA 





- Shfaqjet skenike;
  - Klasifikimin e çdo artisti në ranglistën artistike të çdo sektori;
  - Pranimin dhe përzgjedhjen e artistëve të rinj.
- e) Kanë të drejtë t'i propozojnë Drejtorit të Përgjithshëm pranimin me kontratat afatshkurtëra për artistë të rinj, apo të tjerë gjatë realizimit të shfaqjeve të sezonit artistik;
- f) Kanë detyrë të ndjekin jetën artistike të institucionit dhe të paraqesin raporte periodike pranë Drejtorit të Përgjithshëm, duke evidentuar rezultatet dhe problemet.

#### **Neni 20**

#### **Drejtori i financës dhe dhe i shërbimeve mbështetëse**

1. Drejtori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Drejtori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse duhet të plotësojë kriterin e diplomimit në fushën financiare-ekonomike dhe mban përgjegjësi për aktivitetin ekonomiko-financiar dhe mbështetës të institucionit.
3. Drejtori i financës dhe i shërbimeve mbështetëse, në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejton institucionin në marrëdhënie me të tretët sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 21**

#### **Punësimi**

1. Punësimi në T.K.O.B.A.P bëhet me kontratë individuale ose kolektive pune në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe zakoneve profesionale dhe traditës artistike të institucionit.
2. T.K.O.B.A.P vendos marrëdhëniet e punës me stafin përmes kontratave me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar sipas nevojave administrative institucionale dhe atyre artistike të kalendarit.
3. Rregullimi i marrëdhënieve të punës përsa i përket vleresimit të performancës, përshkrimit individual të punës, masave disiplinore etj përcaktohen në rregulloren e brendëshme të Institucionit.
4. Afatet dhe procedurat e njoftimit referuar procedurave të parashikuara nga Kodi i Punës dhe Kodi i Procedurave Administrative, për çdo rast dhe natyrë të shkeljeve disiplinore, janë si më poshtë:
  - a) Njoftimi për ecurinë disiplinore i drejtohet me shkrim punonjësit të paktën 72 orë përpara takimit dhe të bisedojë me të. Njoftimi drejtohet në vendim e punes ne rast prezencë në punë apo në adresën e vendbanimit të deklaruar nga punonjësi në momentin e lidhjes së kontratës.
  - b) Në takim përveç Titullarit është e detyrueshme prezenca e punonjësit të shërbimeve mbështetëse dhe një punonjësi tjetër të institucionit të përcaktuar nga Titullari. Në rast të

R. XHAJA

mungëses së punonjësit të shërbimeve mbështetëse titullari përcakton një punonjës tjetër të institucionit.

- c) Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede i parashtron punëmarrësit arësyet e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore konkrete dhe te vërtetuar dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur si verbalisht ashtu edhe shkresërisht.
- d) Vendimi për dhënien e masës disiplinore njohtohet me shkrim brenda një afati 48 ore deri në një javë pas takimit.

5. Për takimet e zhvilluara, institucioni mban procesverbalin përkatës i cili duhet të nëshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit. Në rast të refuzimit të nënshkrimit për pranimin e procesverbalit, refuzimi duhet të bëhet i motivuar. Në rast se punonjësi ndaj të cilit është filluar masa disiplinore nuk paraqitet në takim dhe ka marrë njoftim për datën e caktuar, atëherë procesverbali nënshkruhet nga titullari dhe punonjësit e përcaktuar në gërmën b pika 4 e këtij neni.

6. Çdo procedurë e realizuar në kundërshtim me parashikimet e këtij neni konsiderohet apsolutisht i palvefshëm.

## **Neni 22 Organizimi financiar**

Të ardhurat që realizohen nga T.K.O.B.A.P nga shfaqjet (brenda dhe jashtë vendit) dhe aktivitete të tjera të çdo lloji administrohen duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi.

## **Neni 23 Shpërblimi**

Shpërblimi i cilësisë artistike bëhet mbi bazën e legjislacionit në fuqi dhe kontratave mes palëve të cilat nënshkruhen nga titullari i institucionit. Shpërblimi për cilësitë artistike miratohet nga bordi artistik.

## **Neni 24 Shfrytëzimi i Ambienteve**

1. T.K.O.B.A.P ka të drejtë të hyjë në lidhje e marrëdhënie ligjore- financiare me të tretë për të realizuar veprimtari e aktivitete me leverdi ekonomike.
2. Ai ka të drejtë të hapë aktivitete ndihmëse me leverdi ekonomike, të shfrytëzojë bazën materiale – teknike në disponim, lokalet dhe ambjentet e tij duke i dhëne me qera për të tretet (vendas e të huaj) në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 25**

*R. Xhaja*



## Ndryshimet në Statut

Ky status përmirësohet sa herë që praktika e punës dhe ndryshimet në legjislacion e bëjnë të nevojshëm një gjë të tillë. Ndryshimet në statut mund të propozohen edhe nga titullari i institucionit. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Ministri i Kulturës.

### Neni 26 Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri i Kulturës.

PËR

## STATUTI I TEATRI KOMBËTAR I OPERAS BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

miratimi i pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutit dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2017, për "Përkrahjen e Kulturës" i ndryshuar.

### URDHËROJ:

- Miratimi e Statutit të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, sipas tekstit bashkërishtor kësaj Urdhri.
  - Ngarkohet Teatri Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor për abuzimin e kësaj Urdhri dhe Drejtoria e Krijimit të Pjellës dhe Përkrahjes për kësaj Urdhri.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MIRËLA KUMBARO  
Ministër i Kulturës



R. Xaghi